



KOMISIONI RREGULLATOR  
I ENERGJETIKËS DHE I SHËRBIMEVE TË  
UJIT  
TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË  
VERIUT



**NJOFTIM**

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, në bazë të nenit 78 paragrafi (2) pika 12) të Ligjit të Energjetikës\* ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 96/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/19) duhet që të përpunojë plan vjetor për mirëmbajtjen e largpërçuesve të brendshëm të rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike dhe me miratimin paraprak nga Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni Rregullator i Energjetikës) ta publikojë në faqen e tij të internetit.

SHA MEPSO Shkup, më 30 dhjetor 2020 deri te Komisioni Rregullator i Energjetikës dërgoi për miratim Planin e Mirëmbajtjes së Largpërçuesve të Brendshëm për vitin 2021 nr.12-2447/1 datë 30 dhjetor 2020.

Duke pasur parasysh se pas ndërprerjes së gjendjes së jashtëzakonshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut ende ekziston pandemi nga sëmundje ngjitëse dhe është shpallur gjendja e krizës, ndërsa në interes të ruajtjes së shëndetit të palëve, Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit ka vendosur që të mos mbahen seanca përgatitore dhe komunikimi me palët e interesuara të zhvillohet në mënyrë elektronike.

Duke pasur parasysh të lartpërmendurën, në linkun e mëposhtëm është Plani i Mirëmbajtjes së Largpërçuesve të Brendshëm për vitin 2021 të dërguar nga SHA MEPSO Shkup, për të cilin më së voni deri më 18 janar 2021 mund të dërgoni vërejtje, komente dhe sugjerime në [erc@erc.org.mk](mailto:erc@erc.org.mk).

Me respekt,

**Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit  
të Republikës së Maqedonisë së Veriut**

[Plani i Mirëmbajtjes së Largpërçuesve të Brendshëm për vitin 2021 të dërguar nga SHA MEPSO Shkup](#)

